



DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

Datë; 13.01.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA			
KOMUNA – SUHAREKË - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
13-01-2025			
A-PRIL 13-01-2025			
№	Emri	Adresa	Vendi
08	320	2772	f

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohën fermerët e komunës së Suharekës se Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2025, ka paraparë që të bëjë ndërtimin e **SERAVE** me participim për kultivuesit e perimeve.

Llojet e sipërfaqeve për aplikim; 100 m², 200 m² dhe 500 m².

Të drejtën për aplikim e kanë të gjithë fermerët e komunës së Suharekës që i përmbushin kushtet dhe kriteret e parapara si:

- Të jetë i gatshëm të kryej participimin prej 10 %.
- Të prezentojë çertifikatë të pronës së paku 0.50 ha për fermeret që aplikojnë për Seren me sipërfaqe prej **500 m²**.
- Të prezentojë çertifikatë të pronës së paku 0.30 ha për fermeret që aplikojnë për Seren me sipërfaqe prej **200 m²**.
- Të prezentojë çertifikatë të pronës së paku 0.20 ha për fermeret që aplikojnë për Seren me sipërfaqe prej **100 m²**.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.
- Çertifikata e pronës.

Participimi i fermerëve përfitues të Serave do të bëhet duke bërë pagesën e 10 % të vlerës së përgjithshme të serës në llogari të Komunës së Suharekës, ndërsa pjesa tjetër e vlerës apo **90%** nga shuma e përgjithshme financohet nga Komuna e Suharekës.

Informatat dhe data e aplikimit

Aplikacioni merret në zyre të Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari ndërsa aplikimet dorzohen tek Zyra pritëse nr.1 përmes protokollit zyrtar për DBZHRP.

Afati i aplikimit fillon prej datës 13.01.2025 deri me datën 28.01.2025.

Drejtor i DBZHRP

Ardian Kotorri

